



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2527/19 prot.

Datë 11.01.2024

V E N D I M
Nr. 45/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1368/2023, datë 27.12.2023 për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr REF-80592-09-20-2023 me objekt “Blerje karburanti” me fond limit 16.800.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

Ankimues: Operatori ekonomik “UFO CENGU” SHPK, me NIPT: L18328201N, Adresa: Lagjja Ramhas, Rruga Deshmoreve, Zona Kadastrale Nr.2315, Nr.Pasurie 8/8, Kukës

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kukës
Sheshi “Skenderbej, Lagjja Nr.5, Kukës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 27.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1368/2023, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Ufo Cengu” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me nr REF-80592-09- 20-2023 me objekt “Blerje karburanti” me fond limit 16.800.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.10.2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.*
- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Gega Center GKG” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator.*
- 3. Ti propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ sipas konstatimeve të mësipërme të këtij vendimi.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ufo Cengu” SHPK.*
- 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 69 prot., datë 08.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2527/16 prot., datë 10.01.2024, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1368/2023, datë 27.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr REF-80592-09-20-2023 me objekt “Blerje karburanti” me fond limit 16.800.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 69 prot., datë 08.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2527/16 prot., datë 10.01.2024, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1368/2023, datë 27.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr REF-80592-09-20-2023 me objekt “Blerje karburanti” me fond limit 16.800.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, nga ana e autoritetit kontraktor. Nga ky verifikim rezultoi se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr.1368/2023, datë 27.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me nr REF-80592-09-20-2023 me objekt “Blerje karburanti” me fond limit 16.800.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

